



Republika e Kosovës Republika
Kosova – Republic of Kosovo ORGANI
SHQYRTUES I PROKURIMITTELO ZA
RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të,
Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 312 309, email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT TEKNIK Shqyrtues

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Enver BYTYÇI	25.08.2023	11.09.2023	Nr. 2023/0607

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 21.08.2023, OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0607, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “**Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë**” me nr. të prokurimit: “**328-23-6142-2-2-3**”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar:

Lloji i procedurës: Konkurs Projektimi - Procedurë e hapur,

Lloji i kontratës: Shërbim,

Vlera e parashikuar e kontratës: 80,000.00 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2023/0607 i dt: 21.08.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Teknik i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Nga momenti i publikimit për rezultatet e Konkursit të Projektimit, vlerësojmë se janë shkelur:

1.Ligji I Prokurimit Publik, neni 80- 1,2,3

2.Ligji I Prokurimit Publik, neni 52-3

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

ANKESË KUNDËR VENDIMIT TË JURISË PROFESIONALE TË dt.09.08.2023

DHE VENDIMIT PËR REFUZIM TË KËRKESËS SONË PËR RISHQYRTIM PRANË AK TË DT. 15.08.2023

Pas kërkesës me shkrim dhe mundësimit nga Autoriteti Kontraktues për qasje në Projektin Konkurses me shifren 7890 i zgjedhur me më së shumti pikë (23.3), pas shiqimit dhe analizave të bëra nga ne, ai në shumë pozicione ka të meta,dhe si i i tillë, sipas vlerësimit tone, ai nuk meriton të përzgjedhet fitues që të realizohet në teren, bazuar në vërejtjet si më poshtë!

VËREJTJET

Pas shiqimit të projektit fitues pas mundësimit të qasjes, pasi vërejtëm mangësitë në shiqim të parë, na u imponua të angazhohemi për të analizuar më detalisht këtë projekt, që në shumë pika, nuk përmbushë kriteret minimale për objekt të mirëfillët gjykate.

Vërejtjet tona në të metat e Projektit Ideor të Gjykatës Themelore në Pejë,I vlerësuar me 23.3 pikë, që pretendon të realizohet pa meritë në të ardhmën, janë të paraqitura si më poshtë:

SITUACIONI I TERENIT

1. Situacioni I terrenit nuk është bazuar në gjendjen faktike e as ate kadastrale, pasi nuk është marrë parasysh rruga sekondare ekzistuese në veri të parceles ku do të kyqet gjykata. Aty në atë rrugë kyqen edhe ndërtesat tjera në afërsi, andaj duhet përfillur ky fakt. Vërehet se nuk është vizituar fare terreni, edhe pse ka qenë obligim;
2. Vendosja e hyrjes së qytetarëve është në thellësi të anës very jugore të parcelës, e cila vështirë vërehet nga qytetarët kur qasen në oborr. Dmth, ajo ndodhet në pikën më të largët nga syri i qytetarëve- e pa pranueshme;
3. Gjithashtu, pjerrinat (rampat) për hendikep janë me pjerrtësi të madhe jo standarde, dhe nuk prezentohet mirë (nuk ceket se ka pjerrinë dhe pa përqindje apo shkallë të pjerrtësisë). e pa pranueshme;
4. Pjerrina për në bodrum është mu pranë kufirit të parcelës, me qfar rrezikohet muri I oborrit të fqiu privat aty, dhe me siguri as komuna me rastin e dhenjes së lejes ndërtimore nuk do ta pranon- e pa pranueshme;
5. Vërehen trotuare të ndërprera, pra jo kontinuele, e gjithashtu shirita gjelbrues kah parkingjet, të cilat pengojnë lëvizjen, dhe si të tilla do të shkelen me kalim kohe- e pa pranueshme;
6. Distanca e objektit nga kufiri perëndimor, ku ka hapje te zyreve, nuk lejohet më pak se 0.5 h, (h-lartësia e obektit), ndërsa është dikun 6.5 deri 7 m, a duhet të jetë $23/2=11.5$ m. Sipas të gjitha gjasave, ky situacion do të jetë i pa pranueshme nga Drejtoria e Urbanizim të Komunës së Pejës,
7. Futja e veturave në parcelë është gati nën këndin 90 shkallë, dmth, duhet lakuar ose majtas
per te parkingu i hapur ose djathtas per te garazhat në bodrum. Kemi shumë më tepër parkingje se sa janë kërkuar, nga 5 në 22 sosh. Në po të njejtin hyrje futen edhe këmbësorët.
8. Rrethoja në të katër anët siq është paraqitur, nuk po praktikohet, por vetëm kah parcelat fqinje, ato ishin në kohën e UNMIK-ut, e që me kohë janë larguar.

ANALIZA E ZGJIDHJES FUNKSIONALE TË HAPËSIRAVE BRENDË OBJEKTIT

PËRDHESA

1. Posedon pjesërisht hapësirat e administrates, pasi ato janë shpërndarë pa nevojë edhe në katet e tjera, qfar vështirëson apo pamundëson funksionalizimin e punëve të përditshme të adnministratës.Dmth, ato duhet të koncentrohen pranë njëra tjetrës në përdhesë, ndërsa gjykatësit dhe sallat e gjykimit dhe kryetari të jenë neper kate.Edhe administratori nuk është në përdhesë pranë stafit administrative;
2. Holli hyrës si për qytetarët ashtu edhe të zytarëve është i vogël, duke vështirësuar mundësinë e qasjes së lehtë dhe të pa pengueshme në hyrje dhe dalje e edhe në rast të evakuimit emergjent;
- 3.Sigurimi është vendosur vetëm kah hyrja e qytetarëve, e që në raset të caktuara emergjente, do të jetë larg qasjes me hyrjen zyrtare;
- 4.Bifeja është e vendosur në zonën e qytetarëve, qfar duhet të jetë e kundërta, ajo duhet të jetë kah pjesa zyrtare e ndërtsës- zyrtaret duhet kaluar nëper koridorin e qytetarëve-e pa pranueshme;
- 5.Pulti është tejet I mangët, dmth tejet I shkurtër për t'i shërbyer qytetarëve- e pa pranueshme;
- 6.Zyrja për pastrim, ndodhet mu pranë hyrjes për qytetatar, e pa përshtatshme- e pa pranueshme;
- 7.Vërejmë një terasë gjatë pjesës më të madhe lindore dhe veriore, të mbuluar por pa kurrfar destinimi, investim I kotë- e pa pranueshme;
- 8.Dritaret e toaleteve mu pranë hyrjes zyrtare- e pa pranueshme;

ANALIZA E KATIT 1,2,3

1. Gjashtembdhjete zyre ne tri katet për gjykatës dhe bashkëpunëtorë ligjor, posedojnë shtylla konstruktive me

dimensione 45x45cm mu në mes të zyreve, gabim I madh projektues-diqka aspak e pranueshme dhe e pa tolerueshme;

2. Sallat e gjykimit me forma të pa rregullta gjeometrike, ku një pjesë e publikut nuk e shef avokatin apo prokurorin, një zgjidhje e tillë- e pa pranueshme;

3. Tek sallat e gjykimeve nuk vërehen shkallët e as ngritjet e dyshmeve tek paneli I gjykatësve –e pa pranueshme;

4. Dyertë e sallave të gjykimit janë të hapura nga brenda, e jo nga jasht,PASI ATO DUHET TË HAPEN NË DREJTIM TË IKJES obligative për nevoja emergjente të evakuimit, gabim I pa tolerueshëm projektues-e pa pranueshme;

5. Zyret për informim dhe logjistikë preferohet të jenë në përdhesë edhe atë kah pjesa administrative, tek koridori për qytetar s’kanë qfar kërkojnë në mes të gjykatësve- e pa pranueshme;

6. Zyret për prokuror dhe avokat, me formë tejet të ngushtë dhe të gjatë, me afër 2m me 8m e pa pranueshme;

7. Ndriqimi i strehes në kulm (e që si ndriqim atje lart nuk shërben per asgjë e as nuk mirëmbahet si duhet),- e pa pranueshme;

8. Zyret për përmbarues (tejet e hollë dhe e gjatë afer 2.2x8.0m) dhe shefi I zyles, preferohet të jenë në përdhesë edhe ate kah pjesa administrative , këtu me qasje në

koridorin për qytetar s’kanë qfar kërkojnë në mes të gjykatësve- e pa pranueshme;

9. Kapaciteti i hollit të pritjes apo pauzave pranë sallave të gjykimit tejet I vogël, e pa pranueshme;

10.Zyret pa destinim me qasje në koridorin për qytetar, pranë toaletit për qytetarë -e pa pranueshme;

11. Zyrja për informim dhe shefi I zyres, preferohet të jenë në përdhese edhe ate kah pjesa administrative, këtu s'kanë qfar kërkojnë në mes të gjykatësve- e pa pranueshme;

12. Zyrja për Administrator dhe asistent ne katin e trete, me qasje në koridorin dhe tualetet për qytetarë, e jo në ate zyrtare-e pa pranueshme;

13. Salla e madhe e gjykimit ne katin e katert e cila eshte me dimensione ekstremisht disproporcionale- gjatësi me gjërësi (20 x 6.40 m), pra e hollë dhe shumë e gjatë, si dhe përkthyesit duhet të kalojnë pranë trupit gjykues për të hyrë dha dale nga hapësira e destinuar për ta me ndarje nga xhami, pra një zgjidhje e tillë - totalisht e pa pranueshme;

14. Dy sallat e kolegjiutit kanë organizim porsit të sallave të gjykimit, ato nuk kanë tavolina pune përballë gjykatësve si zakonisht për të marrë shenime - e pa pranueshme;

15. Kapaciteti I hollit të pritjes apo pauzave pranë sallës së madhe te gjykimit është I vogël, e pa pranueshme;

16. Zyrja për Kryetar dhe asistent, ka qasjen në koridorin dhe tualetet për qytetarë, pra pa qasje direkte me koridorin zyrtar -e pa pranueshme;

ANALIZA E KULMIT

1.Është i rrafshët, e që nuk është I preferuar pa pjerrtësi, për shkak të mundësisë për dështime të materialeve dhe punimeve hidroizoluese -e pa pranueshme;

VËREJTJE TJERA:

1. MUNGON PRERJA E TRETË QË KËRKOHET NË DETYRËN PROJEKTUESE;

2. ËSHTË APLIKUAR FASADA GJYSËM STRUKTURALE (NE FASADËN LINDORE DHE VERIORE), DRITARE PA NDËRPRERJE ME MURI TEK ZYRET E GJYKATËSVE BRENDA SECILIT KAT, E QË SAKT NË DETYRËN PROJEKTUESE ËSHTË KËRKUAR TË MOS PËRDORET, PASI KEMI HASUR NE VESHTIRËSI GJATË EKZEKUTIMIT TË PUNIMEVE NË TË KALUARËN, PËRQIMI I ZËRIT NGA NJËRA ZYRE NË TJETRËN ETJ.

3. MUNGON PARAMASA ME PARALLOGARI E PËRAFËRT, POR VETËM KOSTOJA E PËRAFËRT E NDËRTIMIT PA NDONJË KALKULIM PARAPRAK

KRITERET PËR VLERËSIM

Sqarimi i Dosjes së Konkursit të Projektimit	14.1	10.07.2023
Dokumentet që përbëjnë dokumentacionin e kandidatit	17.1 (h)	Zarfi që përmban Dokumentacionin e Kandidatit duhet të përmbajë Një (1) Original, dhe Një (1) Kopje.
Dokumentet që përbëjnë Koncept Projektin	18.1 (a)	<p>Për projektim pjesëmarrësit në konkurs do t'i dorëzojnë propozimet e tyre në të njëjtën kohë në dy (2) zarfe të mbyllura të veçanta:</p> <p>1. <u>Zarfi që përmban projektin Ideor do të përmbajë:</u> 1. Ekzemplarin origjinal të projektit; dhe Një (1) kopje të projektit”. 2. Zarfi që përmban Dokumentacionin e Kandidatit duhet të përmbajë një origjinal dhe Një (1) kopje. Pjesëmarrësi do ta mbyllë projektin origjinal dhe kopje në zarfe të veçanta dhe në faqen e përparmë të secilit zarf do të: a. Shënojë qartë si “Origjinali – Projekti Ideor” ose “Kopje – Projekti Ideor”; b. Shënojë numrin e Prokurimit sikurse ceket në dosjen e konkursit të projektimit; dhe c. Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit. Zarfet pastaj do të mbyllën në një zarf të jashtëm, të shënuar qartë “Projekti Ideor” dhe që mban vetëm numrin e prokurimit dhe një numër anonim katër-shifror sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit.</p> <p>2. <u>Zarfi që përmban Dokumentacionin e Kandidatit do të përmbajë:</u> 1. Një (1) Ekzemplarin origjinal të të gjitha kërkesave, teknikë, administrative, dhe tjera të kërkuara në D.T. dhe një (1) kopje</p> <p>Pjesëmarrësi do ta mbyllë ekzemplarin origjinal të dokumentacionit të kandidatit dhe kopjen në zarfe të posaçëm dhe në faqen e përparmë të secilit zarf do të: 1. Shënojë qartë si “Origjinali – Dokumentacioni i kandidatit” ose “Kopje – Dokumentacioni i Kandidatit; 1. Shëno numrin e Prokurimit sikurse ceket në dosjen e konkursit të projektimit; 2. Një numër ANONIM prej katër (4) shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit; dhe 3. Paralajmërimi “mos e hapni me projektin Ideor”. Zarfet pastaj do të mbyllën në një zarf të jashtëm, të shënuar qartë “Dokumentacioni i Kandidatit” dhe që mban vetëm numrin e prokurimit dhe një numër anonim katër-shifror sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit. Të dy zarfet, që përmbajnë “Projektimin Ideor” dhe</p>

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjiilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë**” me numër të prokurimit: “328-23-6142-2-3”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**.

		“Dokumentacionin e Kandidatit” , pastaj do të mbyllet në një zarf të jashtëm të shënuar me: <ul style="list-style-type: none">• Adresën e vendit për dorëzim të konkurseve për projektim;• Numrin e Prokurimit; dhe• Një numër anonim prej katër shifrave sipas zgjedhjes së pjesëmarrësit.											
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	20.1	Afati i fundit për dorëzim është: 01.08.2023 në 14:00:00 orë Vendi: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës rr. Luan Haradinaj 133, nr. zyres 113											
Vlerësimi i Koncept Projekteve	23.1	Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemi i pikëve i cili do të përdoret për vlerësimin e Koncept Projekteve janë:											
			<table><tr><th>Nën-kriteret</th><th>Pesha në %</th></tr><tr><td>Përmbajtja estetike (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional) 30%</td><td>30%</td></tr><tr><td>Përdorimi efikas i hapësirave (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës) 30%</td><td>30%</td></tr><tr><td>Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni 25%</td><td>25%</td></tr><tr><td>Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth (Harmonizimi mjedisor urban) 15%</td><td>15%</td></tr></table>	Nën-kriteret	Pesha në %	Përmbajtja estetike (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional) 30%	30%	Përdorimi efikas i hapësirave (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës) 30%	30%	Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni 25%	25%	Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth (Harmonizimi mjedisor urban) 15%	15%
		Nën-kriteret	Pesha në %										
		Përmbajtja estetike (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional) 30%	30%										
		Përdorimi efikas i hapësirave (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës) 30%	30%										
		Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni 25%	25%										
Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth (Harmonizimi mjedisor urban) 15%	15%												
Pikët Totale për kriteret:													
100%													
Dhënia e projekteve	27.1	Do të shpërblehet vetëm OE, i cili fiton shumicën e pikëve si nga aspekti teknik dhe nga ajo financiar											
Shpërblimi i projekteve	28.2	<table><tr><td>Oferta teknike (projekti)</td><td>60%</td></tr><tr><td>Oferta financiar e projektit (çmimi)</td><td>20%</td></tr><tr><td>Oferta financiar, çmimi i mbikëqyrjes se punimeve te ndërtimit për projektin e ofruar te gjykatës Themelore Pejë</td><td>20 %</td></tr><tr><td colspan="2">Totali = 100</td></tr></table>		Oferta teknike (projekti)	60%	Oferta financiar e projektit (çmimi)	20%	Oferta financiar, çmimi i mbikëqyrjes se punimeve te ndërtimit për projektin e ofruar te gjykatës Themelore Pejë	20 %	Totali = 100			
		Oferta teknike (projekti)	60%										
Oferta financiar e projektit (çmimi)	20%												
Oferta financiar, çmimi i mbikëqyrjes se punimeve te ndërtimit për projektin e ofruar te gjykatës Themelore Pejë	20 %												
Totali = 100													
		Pikë											
	28.4	Numri dhe vlera e shpërblimeve për të dhënë janë: Vetëm Operatorit Ekonomik fitues i kontratës: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për objektin e Gjykatës Themelore Pejë.											
Ankesat	29.3	Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës rr. Luan Haradinaj 133, nr. zyres 113											

Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE dhe/ose estetike TË DETYRUESHME

Përmbajtja e specifikacionit teknik të projektit

Përshkrimin teknik, duke saktësuar, lokacionin në bazë të dimensioneve të tij, përshkrimin e konstruksionit si dhe të gjitha përshkrimet e punëve apo fazave të projektit, Arkitekturën, Llogarinë Statike, Punë Zejtare, Elektrike, Klimatike, Instalime të Ujësjiellësit, kanalizimit, Instalime të teknologjive të larta informatike, shpimet gjeomekanike, matjet gjeodezike etj.

Përshkrimin teknologjik dhe operativ të ekzekutimit të punimeve dhe materialeve të projektuara, ky është një kapitull i veçantë.

Paramsën dhe parallogaritë e saktësuar.

Vizatimet dhe detajet në tërësi duhet të jenë të punuara në përpjesë (P= 1:50)

Projekti kryesor duhet ti përmbaj edhe këto dokumente të rëndësishme:

1. Vendimin mbi emërimin e projektantit kryesor, të arkitekturës, statikes, elektrikes dhe fazave të tjera.
2. Vendimin dhe mendimin se projekti i përfunduar i plotëson të gjitha kushtet sipas Dispozitave Teknike Pozitive për ekzekutim.
3. Vendimin e kompanisë për të gjithë personat përgjegjës të angazhuar në projekt.
4. Projekti Kryesor duhet të punohet në pesë kopje për të gjitha fazat.
5. Deklarate e nënshkruar dhe vulosur nga kompania se përgjigjet për çdo plotësim/ndryshim për kompletimin e projektit që kërkohet kur organet kompetente komunale në vendin ku ndërtohet objekti deri në marrjen e lejes së ndërtimit. Projekti duhet hartuar (punuar) në harmoni të plotë me dispozitat teknike të parapara me Ligjin e Ndërtimit dhe Ligjin e Planifikimit Hapësinor që janë në fuqi në Kosovë.

Kriteret teknike të obligueshme që duhet ti plotësojnë kompanitë për kualifikim.

Të prezantoj projektin ideor të objektit për të cilin oferton (Gjykatën e Themelore Pejë).

Sqarim:

Gjatë punimit të projektit final për të gjitha fazat kompania duhet të konsultohet me zyrtaret kompetent në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor.

Objekti i Gjykatës Themelore Pejë

Hapësirat e nevojshme dhe kërkesat teknike për projektin e objektit të gjykatës

Programi dhe Funkcioni

	<i>Emërtimi i hapësirave-zyrave</i>	<i>Sasia e hapësirës se kërkuar</i>	<i>Njësia</i>	<i>Numri i personave ne zyre.</i>	<i>Hapësirës e përafërte e ofruar m²</i>	<i>Hapësira përafërt totale m²</i>
	Salla te Gjykimit					
1	Salla te gjykimit e madhe	1	cope	80-100	150	150
	Salla te gjykimit e mesme	2	cope	50-60	100	200
	Salle e gjykimit e vogël	12	cope	15-20	30	300
	Zyre për gjykatës					
2	Zyre për gjykatës	30	cope	1	15	450
	Zyre për Bashkëpunëtor dhe Zyrtar Ligjor	30	cope	2	15	450
	Zyre për prokuror dhe avokat	2	cope	1	12	24
	Zyre për kryetar					
3	Zyre për Kryetarin	1	cope	1	30	30
	Zyre për asistent/e	1	cope	1	12	12
	Salle Kolegjiumi e madhe	1	cope	30	60	60
	Zyre për administrator					
4	Zyre për Administrator	1	cope	1	16	16
	Zyre për Asistent	1	cope	1	10	10
	Zyre për informim	1	cope	1	12	12
	Zyra për mbështetje Ligjore					
5	Shefi i zyre	1	cope	1	15	15
	Zyre për përkthyes	2	cope	4	15	30
	Zyra për Menaxhimin e Lendeve					
6	Udhëheqës i Zyrës ML	1	cope	1	15	15
	Shef i Sektorit për ekzekutime	1	cope	1	12	12
	Shef i sektorit	1	cope	1	12	12
	Zyre për referent te lartë dhe zyre për referent	1	cope	6	30	Te sportelet 80
	Zyre për referent te ekzekutimeve, ndihmës referent për ekzekutime dhe e statistikës.	1	cope	6	30	
	Zyre për referent	1	cope	4	20	
	Zyre për Arkivist	1	cope	2	12	12
	Zyre për Përmbarues	1	cope	1	12	12

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë**” me numër të prokurimit: “328-23-6142-2-2-3”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**.

	Zyra për Logjistike, Financa, mbështetje dhe mirëmbajtje					
7	Shefi i zyrës	2	cope	1	15	30
	Zyre për Financa dhe Arkëtar	1	cope	2	15	15
	Zyre për Logjistike	1	cope	1	12	12
	Hapësirë për Receptionsist	1	cope	1	6	6
	Zyre për Dorëzues, shtëpiak dhe vozitës	1	cope	5	25	25
	Zyre për pastrues	1	cope	3	15	15
	Zyre për sigurim	1	cope	1	12	12
	Hapësirat tjera për objekt					
8	Arkiva 1	1	cope	1	150	150
	Arkiva 2	1	cope	1	100	100
	Biblioteka	1	cope	1	30	30
	Hapësira për te paraburgosur	3	cope	2	8	24
	Bife	1	cope	20	40	40
	Hapësira komunikuese dhe nyejt sanitare sipas normave për projektim					
9	Etazhiteti i objekti duhet te jete jo me pak se B+P+4					
10	Objekti duhet te ketë sipërfaqe neto max. deri ne 5000 m ²					
11	Për objekt duhet te parashihen edhe ashensorët.					
	KËRKESAT FUNKSIONALE					
12	Objekti duhet të ketë dy hyrje: Hyrjen kryesore për publikun dhe hyrjen për stafin e gjykatës.					
13	Hapësirat nëpër korridore për publikun duhet të jenë të ndara nga pjesa e hapësirave për gjykatës.					
14	Në përdhese duhet të parashihen hapësirat për: <ul style="list-style-type: none"> - Pritje për palë, - Kontroll për sigurimin, - Receptionsi, - Zyrat për punë me palë (zyra për menaxhimin e lëndëve) duhet të jenë të tipit të hapur transparente nga ana e publikut. Ndarja duhet të bëhet me xhama (sportele) - Bufe. 					
15	Në Bodrum duhet të parashihen hapësirat për: <ul style="list-style-type: none"> • Hapësirat teknike dhe • Hapësira për arkivat dhe • Autoparkim 					
16	Organizimi i zyrave për: <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimin e lëndëve, - Logjistikë, - Financa - Mbështetje dhe mirëmbajtje 					

	Për shefa të zyrave, zyra duhet të jetë e ndarë nga pjesa e zyrtarëve kurse për zyrtarë hapësirat duhet të jenë të hapura.		
17	Sallat e madhe të gjykimit duhet të posedojnë hapësirën për përkthyes (3) ,hapësirën për këshillime (5) dhe hapësirën për te paraburgosur (1).		
18	Hyrjet në sallë të gjykimit duhet të jenë të ndara për gjykatës dhe për palë, hyrja për gjykatës në sallë të gjykimit duhet të realizohet përmes pjesës së korridoreve e cila është e kufizuar për publikun.		
19	Sallat e gjykimit me kapacitet mbi 50 persona për publikun duhet të kenë qasje të veçanet nga qasja e gjykatësve.		
20	Zyra e kryetarit duhet të ketë lidhshmëri me asistentin/e dhe sallën e kolegjiut.		
21	Zyrat e Gjykatësve duhet të kenë hapësira se paku prej 15 m ² . Zyre për Bashkëpunëtor dhe Zyrtar Ligjor duhet jetë si para zyre e zyrës së gjyqtarit e cila do të ketë ndriçimin prej zyrës së gjykatësit.		
22	Zyrat për zyrtar tjerë jene sipas normave dhe numrit të punëtoreve		
23	Projekti duhet të përfshij komplet objektin dhe stacionin e parcelës.		
24	Për auto parkim jashtë objekti të parashikohet për 5 vende		
25	Ne kuadër sallave të vogla të gjykimit të planifikohet edhe një sallë e gjykimit për të mitur		

1. Detyra Projektuese

Përmbajtja e projektit ideor:

	Përshkrimi	Përmasat
1.	Projekti ideore dorëzohet në 1 kopje të shkruar dhe 1 në mënyrë elektronike, projekti në PDF kurse paramasat dhe parallogaritë në EX.	
2.	Situacioni	P=1:500
3.	Të gjitha bazat e kateve	P=1:100
4.	Baza e Themeleve	P=1:100
5.	Baza e Kulmit	P=1:100
6.	Prerjet Karakteristike të objektit (së paku 3 prerje)	P=1:100
7.	Të gjitha dukjet (fasadat)	P=1:100
8.	Kostoja e përafërt financiare ne euro për ndërtimin e objektit për projektin ideor të propozuar.	

Përmbajtja e Projektit Kryesor për kompaninë Fituese:

	Përshkrimi	
	Projekti kryesor dorëzohet në 5 kopje të shkruar dhe 1 USB , projekti në PDF kurse paramasat dhe parallogaritë në Excel.	
	Arkitektura	
	Situacioni me rrethinë	P=1:500
	Situacioni	P=1:200

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë**” me numër të prokurimit: “328-23-6142-2-2-3”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**.

Të gjitha bazat e kateve	P=1:50
Baza e Themeleve	P=1:50
Baza e Kulmit	P=1:50
Prerjet Karakteristike të objektit (së paku 3 prerje) P=1:50	
Të gjitha dukjet (fasadat)	P=1:50
Detajet e nevojshme	P=1:10 ose P=1:5
Perspektiva	
Llogaria Statike	
Instalimet e makinerisë	
Instalimet elektrike	
Instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit	
Instalimet e „IT” (teknologjisë informative)	
Elaboratin kundër zjarrit dhe te gjitha elaboratet qe kërkohen nga komuna e Prizrenit	

Vërejtje: Fasadat e jashtme te objektit “**Gjysëm Strukturale dhe Strukturuale**“ **NUK PRANOHEN**

2. Zgjidhja ideore

Zgjidhja idore duhet te permbaje:

- Situacioni 1: 500
- Te gjitha bazat 1: 100
- Prerjet karakteristike 1 : 100
- Duket 1: 100
- Prespektive – Aksonometr

3. Përshkrimi teknik

Përshkrimi teknik duhet te permbaje :

- Situacionin
- Funksionimin
- Konstruksionin
- Arkitektura
- Urbanistika
- Përshkrimi i konceptit arkitektural funksional.
- Destinimi i kthinave te objektit.
- Kostoja aproksimative e objektit.

Oferta Teknike, kriteret e vlerësimit te projektit ideor

Tabela 1.

Kriteri		Pesha ²	Metoda e vlerësimit
1	Përmbajtja estetike (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional)	30 %	$T = \frac{T_t}{T_s} \times <100\% >^2$ $[T = \frac{T_t}{T_s} \times <100\% >^3$
2	Përdorimi efikas i hapësirave (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës)	30 %	
3	Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni)	25 %	
4	Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth (Harmonizimi mjedisor urban)	15 %	
		100 %	

Sqarim:

- 1.Oferta teknike e projektit e peshuar me pike më së shumti nga Juria 1, automatikisht merr maximumin e pikëve;
- 2.Pjesa financiare me çmimin me te ulet do te merr maksimumin e pikëve financiare dhe ofertat e tjera llogariten ne proporcion sipas peshës ne raport me ofertën e pare.

Kriteret e vlerësimit të ofertës për dhënie të kontratës

Tabela 2

Përshkrimi	Pikët
Oferta teknike (projekti)	60
Oferta financiar e projektit (çmimi)	20
Oferta financiar, çmimi i mbikëqyrjes se punimeve te ndërtimit për projektin e ofruar te gjykatës në Pejë	20
MAX i Pikëve	100

² Pesha që i jepet secilit kriter (në % - totali i të gjitha peshave duhet të jetë i barabartë me 100)

³ ku T= pikët e projektit, Ts= Projekt i vlerësuar si më i miri, Tt = projekti aktual

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë**” me numër të prokurimit: “328-23-6142-2-2-3”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**.

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
 SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT - SECRETARAT

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik

Vlerësimi i projektit ideor nga Juria konform nenit 80 të LPP rrezultati i Jurisë: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë” Numri i aktivitetit të prokurimit: 328-23-6142-2-2-3, Nr i brendshëm: 33300/023/017/223

Nr.	Kodi i Operatorit Ekonomik	Piket e projektit
1.	7890	23.3%
2.	2000	16.5%
3.	7878	13.9%
4.	1616	11.9%
5.	1183	8.9%

Data:09.08.2023

Anetaret e Jurisë

1. Prof. Asoc. Dr. – Arkitekture M.D. *M. Prizgalli*
2. Ass.Dr.-Arkitekture- B.K.B *[Signature]*
3. Inxh.i Dip. I Maxhineris---A.Z *[Signature]*

*Besim Mag-donari
 Shef i agjensë prokurimit*

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë**” me numër të prokurimit: “**328-23-6142-2-2-3**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT - SECRETARAT

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TENDERËVE

Procedura e Hapur

Sipas Nenit 75 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data kur është përgatitur Raporti i Jurisë për projektin ideor : 09.08.2023

Nr. i prokurimit ¹	33300	23	17	223
-------------------------------	-------	----	----	-----

Titulli: Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë,

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me aktivitetin e prokurimit.
Formulari standard “Raporti i Vlerësimit të Tenderëve– procedura e hapur”

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë”** me numër të prokurimit: **“328-23-6142-2-2-3”**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës.**

Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për objektin e Gjykatës Themelore Peje

Oferatat	Oferta 7890				Oferta 7878				Oferta 1183				Oferta 2000			
Kriteret	MD	BKB	AZ	mesatarja	x	y	z	mesatarja	x	y	z	mesatarja	x	y	z	mesatarja
Përmbajtja estetike (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional) 30%	25	25	25	25	15	15	15	15	10	10	10	10	17	17	17	17
Përdorimi efikas i hapësirave (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës) 30%	30	30	30	30	20	20	20	20	10	10	10	10	25	25	25	25
Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni 25%	20	20	20	20	10	10	10	10	8	8	8	8	12	12	12	12
Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth (Harmonizimi mjedisor urban) 15%	12	12	12	12	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6	6

Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve-- procedura e hapur"

2

Oferatat	Oferta 1616			
Kriteret	x	y	z	mesatarja
Përmbajtja estetike (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional) 30%	13	13	13	13
Përdorimi efikas i hapësirave (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës) 30%	17	17	17	17
Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni 25%	8	8	8	8
Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth (Harmonizimi mjedisor urban) 15%	6	6	6	6

Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve-- procedura e hapur"

3

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë”** me numër të prokurimit: **“328-23-6142-2-2-3”**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës.**

Oferatat	Oferta 7890			Oferta 7878			Oferta 1183			Oferta 2000		
Kriteret	mesaterja	pesha	Piket	mesaterja	pesha	Piket	mesaterja	pesha	Piket	mesaterja	pesha	Piket
Përmbajtja estetike (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional) 30%	25	30	7.5	15	30	4.5	10	30	3	17	30	5.1
Përdorimi efikas i hapësirave (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës) 30%	30	30	9	20	30	6	10	30	3	25	30	7.5
Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni 25%	20	25	5	10	25	2.5	8	25	2	12	25	3
Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth (Harmonizimi mjedisor urban) 15%	12	15	1.8	6	15	0.9	6	15	0.9	6	15	0.9
			23.3			13.9			8.9			16.5

Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve-- procedura e hapur"

4

Oferatat	Oferta 1616		
Kriteret	mesaterja	pesha	Piket
Përmbajtja estetike (Arkitektura, zgjedhja e konceptit arkitektural, funksional) 30%	13	30	3.9
Përdorimi efikas i hapësirave (destinimi i kthinave të objektit, shfrytëzimi racional i hapësirës) 30%	17	30	5.1
Inovacioni (Zgjedhja e konceptit struktural të objektit, Konstruksioni 25%	8	25	2
Përshtatjen adekuate me mjedisin përreth (Harmonizimi mjedisor urban) 15%	6	15	0.9
			11.9

Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve-- procedura e hapur"

5

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë**” me numër të prokurimit: “328-23-6142-2-2-3”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**.

LISTA E PLOTË STANDARDE E RADHITJES SË TENDERËVE SIPAS KRITERIT TË DHËNIES

Identifikimi i tenderuesit të rekomanduar për dhënie të kontratës²

Tenderuesi	Kodi i tenderuesit të suksesshëm		
1.	7890		

Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve-- procedura e hapur"

6

DEKLARATË

Komisioni (Juria) konform me LPP, nenin 80 dhe RRUOPP, nenit 57.26 dhe 57.29, për vlerësimin e projektit ideor juria konstaton se kodi 7890 është vlerësuar nga Juria me maksimumin e pikëve.

Komisioni i vlerësimit të tenderëve					
	1. Kryesuesi	2. Anëtar	3. Anëtar		
Emri:					
Mbiemri:					
Profesioni:	Prof. Asoc. Dr. – Arkitekture	Ass.Dr.-Arkitekture	Keshilltar Profesional Inxh. I Maxhineris		
Nënshkrimi:	<i>Mupogalli</i>	<i>AK</i>	<i>AK</i>		
Data:	09.08.2023	09.08.2023	09.08.2023		

Formulari standard "Raporti i Vlerësimit të Tenderëve-- procedura e hapur"

7

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan, lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë”** me numër të prokurimit: **“328-23-6142-2-2-3”**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Këshilli Gjyqësor i Kosovës**.

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

Me dt.06.09.2023 Eksperti ka mbajtur takim ne AK dhe ka marre dokumentet e projekteve dhe raportin e komisionit te vleresimit të ofertave, Dokumentet e projekteve jane siguruar ne kopje elektronike ndersa raporti kopje fizike.
Dokumentet tjera te procedures jane siguruar nga sistemi i prokurimit elektronik.

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

Eksperi shqyrtues konstaton se pala ankuese eshte pale e interesuar sipas LPP.

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES – “Advanced Group of Architecture”

Sqarim hyrës:

Autoriteti Kontraktues **Këshilli Gjyqësor i Kosovës** ka zhvilluar procedurën e prokurimit me titull: **“Punimi i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Pejë”**
Me numër prokurimit: “328-23-6142-2-2-3”

Njoftimi për Konkursin e Projektimit: 16.06.2023

Afati i fundit për dorëzimin e Tenderit: 01.08.2023

AK ka publikuar njoftimin vendimin e AK me dt.09.08.2023

Me dt.14.08.2023 operatori ekonomik “Advanced Group of Architecture” ka ushtruar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së me pretendimet ankimore kundër vendimit të AK-së.

AK me dt. 15.08.2023 ka nxjerrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

Me dt. 21.08.2023 kundër këtij vendimi të AK, OE ka parashtruar ankesë me nr.2023/0607 kundër njoftimit mbi vendimin e AK pranë OSHP.

Me dt. 25.08.2023 me kërkesë të ekspertit shqyrtues, OSHP konform ligjit me datë 25.08.2023 ka autorizuar ekspertin teknik.

Eksperti teknik sipas autorizimit për lëndën nr. 2023/0607 në pajtim me nenin 114 të ligjit per Prokurim Publik – LPP, i ka shqyrtuar te gjitha pretendimet ankimore të OE ankues dhe për këto pretendime konstaton se:

Pretendimi ankimor 1:

Sipas pretendimit ankimor 1 operatori ekonomik ankues ka ngritur 8 pika në të cilat ka shfaqur vërejtjet si më poshtë për të cilat eksperti edhe ka bërë vlerësimin e fakteve dhe sqaron se:

SITUACIONI I TERENIT

1. Situacioni I terrenit nuk është bazuar në gjendjen faktike e as atë kadastrale, pasi nuk është marrë parasysh rruga sekondare ekzistuese në veri të parceles ku do të kyqet gjykata. Aty në atë rrugë kyqen edhe ndërtesat tjera në afërsi, andaj duhet përfillur ky fakt. Vërehet se nuk është vizituar fare terreni, edhe pse ka qenë obligim;

2. Vendosja e hyrjes së qytetarëve është në thellësi të anës very jugore të parcelës, e cila vështirë vërehet nga qytetarët kur qasen në oborr. Dmth, ajo ndodhet në pikën më të largët nga syri i qytetarëve- e pa pranueshme;

3. Gjithashtu, pjerrinat (rampat) për hendikep janë me pjerrtësi të madhe jo standarde, dhe nuk prezantohet mirë (nuk ceket se ka pjerrinë dhe pa përqindje apo shkallë të pjerrtësisë). e pa pranueshme;

4. Pjerrina për në bodrum është mu pranë kufirit të parcelës, me qfar rrezikohet muri I oborrit të fqiu privat aty, dhe me siguri as komuna me rastin e dhenjes së lejes ndërtimore nuk do ta pranon- e pa pranueshme;

5. Vërehen trotuare të ndërprera, pra jo kontinuele, e gjithashtu shirita gjelbrues kah parkingjet, të cilat pengojnë lëvizjen, dhe si të tilla do të shkelen me kalim kohe- e pa pranueshme;

6. Distanca e objektit nga kufiri perëndimor, ku ka hapje të zyreve, nuk lejohet më pak se 0.5 h, (h-lartësia e objektit), ndërsa është dikur 6.5 deri 7 m, a duhet të jetë $23/2=11.5$ m. Sipas të gjitha gjasave, ky situacion do të jetë i pa pranueshme nga Drejtoria e Urbanizimit të Komunës së Pejës,

7. Futja e veturave në parcelë është gati nën këndin 90 shkallë, dmth, duhet lakuar ose majtas

për të parkingut i hapur ose djathtas për të garazhat në bodrum. Kemi shumë më tepër parkingje se sa janë kërkuar, nga 5 në 22 sosh. Në po të njëjtin hyrje futen edhe këmbësorët.

8. Rrethoja në të katër anët siq është paraqitur, nuk po praktikohet, por vetëm kah parcelat fqinje, ato ishin në kohën e UNMIK-ut, e që me kohë janë larguar.

Pergjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 1:

1. Pas analizes se situacionit të dhënë nga AK dhe verifikimit të detyrës projektuese eksperti vlerëson se AK i ka lënë të lirë operatorët ekonomik ofertues në pozicionimin e objektit dhe dhënien e zgjidhjes më funksionale për të cilën OE duhet të ofrojnë.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 1, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

2. Në bazë të organizimit të hapësirës dhe funksionit si dhe orientimin e objektit në parcelën e ofruar nga AK, pretendimi në pikën 2 është i parasyshëm pasi që për qështjet e organizimit të hapësirave dhe orientimit të tyre i takon AK të vlerësoj përmes komisionit profesional gjatë vlerësimit se cila është zgjedhja më e mirë funksionale, nuk është kompetence e OE që të jep vlerësime jashtë parametrave të detyrës projektuese.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 2, konsideron se pretendimi në pikën 2 është i pabazuar.

3. Në bazë të analizës së projektit ideor përqindja e pjerrtësive për personat me aftësi të kufizuara, nuk janë të shenjura në skica dhe nuk dihet saktë përqindja e pjerrtësisë, mirëpo ky parametër verifikohet dhe qartësohet në procesin e hartimit të projektit kryesor pasi që është kërkesë ligjore.

Eksperti Teknik në pikën 3 konsideron se pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

4. Qasja në bodrum është afër parcelës dhe se me ligjin për mbrojtje nga zjarri duhet të sigurohet lëvizje e lirë e makinerisë për rreth objektit kështu që në trajtimin e pikës 4 ka mangësi dhe se Autoriteti kontraktues gjatë poentimit duhet të marrë parasysh këtë fakt.

Eksperti Teknik në pikën 4 konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar.

5. Në pikën 5 janë ngritur qështje të funksionit të lëvizjes dhe hapësirave gjelbëruese në parter, të cilat janë paraqitur në situacion. I përket AK të vlerësoj në lidhje me zgjidhjen e ofruar.

Eksperti Teknik në pikën 5 konsideron se pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

6. Qështja e definimit të pozicionimit definohet në fazën e aplikimit për kushtet ndërtimore dhe paisjes me leje ndërtimore. Në këtë fazë është shqyrtuar projekti ideor, mirëpo mos respektimi i kushteve ndërtimore pamundeson realizimin e projektit. Ky fakt duhet të merret parasysh gjatë poentimit të projektit në fazën e vlerësimit.

Eksperti Teknik në pikën 6 konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar.

7. Organizimi i hapësirës dhe funksionit në hapësirën e jashtme rregullohet në fazën e projektit kryesor dhe në këtë fazë paraqitet vetëm zgjidhjet ideore.

Eksperti Teknik në pikën 7 konsideron se pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

8. Qështja e rrethojës së parcelës është qështje e institucionit- investitorit e jo qështje e OE andaj nuk është pjesë e detyrës dhe nuk trajtohet.

Eksperti Teknik në pikën 8 konsideron se pretendimi i OE ankues është i pabazuar.

Pas shqyrtimit të të gjitha pikave në pretendimin 1- Eksperti konsideron se pretendimi 1 është pjesërisht i bazuar.

Pika 4 dhe 6 gjatë rivlerësimit duhet të merret parasysh tek poentimi.

Pretendimi ankimor 2:

Sipas pretendimit ankimor 2 operatori ekonomik ankues ka ngritur 8 pika në të cilat ka shfaqur vlerësimet si me poshte për të cilat eksperti e ka bërë vlerësimin e fakteve dhe ka dhënë sqarimet dhe përgjigjet në secilën prej pikave.

PËRDHESA

1. Posedon pjesërisht hapësirat e administrates, pasi ato janë shpërndarë pa nevojë edhe në katet e tjera, qfar vështirëson apo pamundëson funksionalizimin e punëve të përditshme të adnministratës.Dmth, ato duhet të koncentrohen pranë njëra tjetrës në përdhesë, ndërsa gjykatësit dhe sallat e gjykimit dhe kryetari të jenë neper kate.Edhe administratori nuk është në përdhesë pranë stafit administrative;
2. Holli hyrës si për qytetarët ashtu edhe të zytarëve është i vogël, duke vështirësu mundësinë e qasjes së lehtë dhe të pa pengueshme në hyrje dhe dalje e edhe në rast të evakuimit emergjent;
- 3.Sigurimi është vendosur vetëm kah hyrja e qytetarëve, e që në raset të caktuara emergjente, do të jetë larg qasjes me hyrjen zyrtare;
- 4.Bifeja është e vendosur në zonën e qytetarëve, qfar duhet të jetë e kundërta, ajo duhet të jetë kah pjesa zyrtare e ndërtsës- zyrtaret duhet kaluar nëper koridorin e qytetarëve-e pa pranueshme;
- 5.Pulti është tejet I mangët, dmth tejet I shkurtër për t'i shërbyer qytetarëve- e pa pranueshme;
- 6.Zyrja për pastrim, ndodhet mu pranë hyrjes për qyetatar, e pa përshtatshme- e pa pranueshme;
- 7.Vërejmë një terasë gjatë pjesës më të madhe lindore dhe veriore, të mbuluar por pa kurrfar destinimi, investim I kotë- e pa pranueshme;
- 8.Dritaret e toaleteve mu pranë hyrjes zyrtare- e pa pranueshme;

Pergjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 2:

1. Në pikën 1 OE ankues ka paraqitur vërejtjet në organizimin e zyreve dhe funksionimin e tyre, sa i përket organzimit të zyreve AK nuk e ka kufizuar përmbajtjen në etazha përveç kërkesës së përgjithëshme ne

kërkesat funksionale të cilat i ka plotësuar projekti fitues. Përgjegjësi e AK është mënyra e funksionimit të administratës dhe vlerësimit të funksionit të objektit.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 1, konsideron se pretendimi në pikën 1 është i pabazuar.

2. Në pikën 2 pretendimi se holli hyrës është i vogël, konsiderohet se sa i përket shfrytëzimit dhe hapësirës së hollit nuk është e përshkruar në dosje të tenderit, AK duhet të vlerësoj se a janë plotësuar kriteret.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 2, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

3. Në dosje të tenderit në kërkesat funksionale është kërkuar që të ketë kontroll për sigurimin, OE ankues ka shfaqur vërejtjet se Kontrolli i sigurisë është largë hyrjes për zyrtarë të administratës. Meqenëse janë kërkuar dy hyrje të objektit, kontrolli i sigurisë parashihet të ndodhë në hyrjen e palëve. AK vendos se a duhet të ketë edhe tek hyrja për administratë apo jo.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 3, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

4. Në dosje të tenderit është kërkuar të jetë Bufer, meqenëse objekti është i ndarë në funksion (administratë dhe Palë), sa i përket vendosjes së bifesë nuk është specifikuar pjesa ku dhe të vendoset bifeja, mirë do ishte të vendosej në pjesë neutrale me qasje të barabartë. AK ka vlerësuar dhe përgjegjësi e AK është sa i përket funksionit të bifesë.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 4, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

5. Pulti për ti shërbyer palëve në pjesën e përcaktuar, është në përgjegjësi e AK në bazë të numrit të palëve, por nuk është specifikuar në dosje dhe për funksion i takon AK të vendos dhe ti merr parasysh gjatë poentimit.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 5, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

6. Pika 6,7 dhe pika 8 janë qështje që AK i konsideron në funksion të objektit, AK e vlerëson se a i plotësojnë kërkesat e tyre apo jo.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 6,7 dhe 8, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

Pas shqyrtimit të të gjitha pikave në pretendimin 2 - Eksperti konsideron se pretendimi 2 është i pabazuar.

Pretendimi ankimor 3:

Sipas pretendimit ankimor 3 operatori ekonomik ankues ka ngritur 16 pika në të cilat ka shfaqur vërejtjet si me poshte për të cilat eksperti e ka bërë vlerësimin e fakteve dhe ka dhënë sqarimet dhe përgjigjet në secilen prej pikave.

ANALIZA E KATIT 1,2,3

1. Gjashtembjedhete zyre ne tri katet për gjykatës dhe bashkëpunëtorë ligjor, posedojnë shtylla konstruktive me

dimensione 45x45cm mu në mes të zyreve, gabim I madh projektues-diqka aspak e pranueshme dhe e pa tolerueshme;

2. Sallat e gjykimit me forma të pa rregullta gjeometrike, ku një pjesë e publikut nuk e shef avokatin apo prokurorin, një zgjidhje e tillë- e pa pranueshme;

3. Tek sallat e gjykimeve nuk vërehen shkallët e as ngritjet e dyshmeve tek paneli I gjykatësve –e pa pranueshme;

4. Dyertë e sallave të gjykimit janë të hapura nga brenda, e jo nga jasht,PASI ATO DUHET TË HAPEN NË DREJTIM TË IKJES obligative për nevoja emergjente të evakuimit, gabim I pa tolerueshëm projektues-e pa pranueshme;

5. Zyret për informim dhe logjistikë preferohet të jenë në përdhesë edhe atë kah pjesa administrative, tek koridori për qytetar s’kanë qfar kërkojnë në mes të gjykatësve- e pa pranueshme;

6. Zyret për prokuror dhe avokat, me formë tejet të ngushtë dhe të gjatë, me afër 2m me 8m e pa pranueshme;

7. Ndriqimi i strehes në kulm (e që si ndriqim atje lart nuk shërben per asgjë e as nuk mirëmbahet si duhet),- e pa pranueshme;

8. Zyret për përmbarues (tejet e hollë dhe e gjatë afer 2.2x8.0m) dhe shefi I zyles, preferohet të jenë në përdhesë edhe ate kah pjesa administrative , këtu me qasje në

koridorin për qytetar s'kanë qfar kërkojnë në mes të gjykatësve- e pa pranueshme;

9. Kapaciteti i hollit të pritjes apo pauzave pranë sallave të gjykimit tejet I vogël, e pa pranueshme;

10. Zyret pa destinim me qasje në koridorin për qytetar, pranë toaletit për qytetarë -e pa pranueshme;

11. Zyrja për informim dhe shefi I zyres, preferohet të jenë në përdhese edhe ate kah pjesa administrative, këtu s'kanë qfar kërkojnë në mes të gjykatësve- e pa pranueshme;

12. Zyrja për Administrator dhe asistent ne katin e trete, me qasje në koridorin dhe tualetet për qytetarë, e jo në ate zyrtare-e pa pranueshme;

13. Salla e madhe e gjykimit ne katin e katert e cila eshte me dimensione ekstremisht disproporcionale- gjatësi me gjërësi (20 x 6.40 m), pra e hollë dhe shumë e gjatë, si dhe përkthyesit duhet të kalojnë pranë trupit gjykues për të hyrë dha dale nga hapësira e destinuar për ta me ndarje nga xhami, pra një zgjidhje e tillë - totalisht e pa pranueshme;

14. Dy sallat e kolegjiutit kanë organizim porsit të sallave të gjykimit, ato nuk kanë tavolina pune përballë gjykatësve si zakonisht për të marrë shenime - e pa pranueshme;

15. Kapaciteti I hollit të pritjes apo pauzave pranë sallës së madhe te gjykimit është I vogël, e pa pranueshme;

16. Zyrja për Kryetar dhe asistent, ka qasjen në koridorin dhe tualetet për qytetarë, pra pa qasje direkte me koridorin zyrtar -e pa pranueshme;

Pergjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 3:

Pas analizes së pretendimit 3 dhe vlerësimit të projektit eksperti teknik konsideron se:

1. Pretendimi ne piken 1 eshte i arsyeshem dhe në mes të kthinave ekzistojnë shtyllat sipas dimensioneve të cekura, gjë që në aspektin profesional funksional të projektit është defekt i cili paraqet pengesa të mëdha në funksionim të kthinave. Andaj Komisioni i vlerësimit gjatë poentimit është dashtë të merrë parasysh në kuadër të kriterëve të vlerësimit funksional.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 1, konsideron se pretendimi eshte i bazuar.

2. Pretendimi i palës ankuese se format e sallave të gjykimit janë të parregullta, paraqitet vetem te nje sallë e cila nuk eshte e parregullt, meqenëse në këtë fazë bëhet vlerësimi i propozimi idesë atëherë kjo mund të përmirësohet dhe nuk paraqet pikë që duhet trajtuar tani.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 2, konsideron se pretendimi eshte i pabazuar.

3. Shkallët e ngritjeve në sallat e gjykimeve nuk janë paraqitur në bazë e as në prerje, këto vërejtje nuk ndikojnë në funksion të objektit pasi që trajtohen gjatë projektimit të projektit kryesor.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 3, konsideron se pretendimi eshte jo relevant për projektin.

4. Pretendimi ankimor në pikën e 4 është i qëndrueshëm pasi që dyert në objektet publike ku ka grupe

njerëzish në hapësira të mbyllura duhet të kenë hapje nga jashtë për shkak të sigurisë dhe drejtimit të daljes në raste emergjente.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 4, konsideron se pretendimi është i bazuar. Dyert duhet të kenë hapje nga jashtë.

5. Zyret për informim preferohet të jenë në pjesën administrative dhe në këtë rast OE ankues ka të drejtë në pikën ankimore. Gjatë vlerësimit duhet të merren parasysh këto mangësi në poentim të projektit.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 5, konsideron se pretendimi është i bazuar.

6. Organizimi i zyreve (flitet për 2 zyre) për prokuror dhe avokat mbetet në kompetencën e vlerësimit të AK gjatë përzgjedhjes së projektit, pasi që sipas organizimit levizshmëria është e mjaftueshme dhe gjerësit e zyreve janë mbi 2 m sipas proporcionit.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 6, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

7. Sa i përket ndriçimit të strehes në kulm është në kuadër të zgjidhjes arkitektonike të projektit dhe për këtë vlerësohet nga Komisioni i AK.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 7, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

8. Zyra e permbaruesit është trajtuar në pikën 6, ndërsa sa i përket kthines për shefin e zyrës, në aspektin e funksionit administrativ kjo është kompetencë e AK.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 8, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

9. Kapaciteti i hollit pritës në bazë të vlerësimit të hapësirave dhe numrit të sallave të gjyqimit është i vogël andaj duhet të merret parasysh në funksion dhe kriterin e lëvizshmërisë.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 9, konsideron se pretendimi është i bazuar.

AK duhet të marrë parasysh gjatë vlerësimit dhe poentimit.

10. Pika 10 nuk paraqet shkelje të normave dhe detyres projektuese andaj konsiderohet e pabazuar

11. Pika 11 nuk paraqet shkelje të detyres projektuese andaj konsiderohet e pabazuar

12. Funksioni administrativ mbetet në kompetencë të AK gjatë vlerësimit andaj konsiderohet e pabazuar.

13. Verejtjet e dhena për sallën e madhe janë të bazuara pasi që funksioni i kësaj sale është mjaft i vështirë për palët pjesëmarrës, hollit pritës i vogël, interferimi i palëve, mungesa e hapësirave të mjaftueshme përcjellëse.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 13, konsideron se pretendimi është i bazuar.

AK duhet të marrë parasysh në fazën e vlerësimit pasi mund të ndryshoj rrjedhën e poentimit.

14. Organizimi i sallave të kolegjiut mund të përmirësohet në hartimin e projektit kryesor dhe nuk paraqet për këtë fazë fakte të rëndësishme që mund të ndryshojnë rrjedhën e vlerësimit.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 14, konsideron se pretendimi është i pabazuar.

15. Kapaciteti i sallës së madhe sa i përket numrit të personave është 80 deri 100 sipas detyrës projektuese, andaj pretendimi për kapacitetin e hollit pritës dhe të pauzës është me të drejtë duke llogaritur kapacitetin e sallës.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 15, konsideron se pretendimi është i bazuar.

16. Në aspektin administrativ zyra e kryetarit duhet të ketë qasje nga ana administrative dhe këtu ka të drejtë OE ankues.

Eksperti Teknik sa i përket pikës 16, konsideron se pretendimi është i bazuar.

Pas shqyrtimit të të gjitha pikave në pretendimin 3 - Eksperti konsideron se pretendimi 3 është i bazuar pjesërisht dhe mund të ndikoj në renditjen e pikëve të vlerësimit.

Pretendimi ankimor 4:

ANALIZA E KULMIT

1. Është i rrafshët, e që nuk është I preferuar pa pjerrtësi, për shkak të mundësisë për dështime të materialeve dhe punimeve hidroizoluese -e pa pranueshme;

Pergjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 4:

Pretendimi nga OE ankues për zgjedhjen e konstruksionit te kulmit të rrafshët nuk qendron pasi që OE ka supozuar se ndërtimi do të bëhet jashtë normave dhe standardeve dhe e paragjykon situaten për deshtimin e punimeve. Ky pretendim nuk eshte i bazuar pasi kulmet e rafshta nuk paraqesin problem për konstruksionet vetëm se duhet të parashihen të gjitha punimet dhe materializimet konform normave ndërtimore.

Eksperti Teknik konsideron se pretendimi 4 i OE ankues eshte i pabazuar.

Pretendimi ankimor 5:

1. MUNGON PRERJA E TRETË QË KËRKOHET NË DETYRËN PROJEKTUESE;

Pergjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 5:

Në detyrën projektuese tek përmbajtja e projektit ideor pika 6. Kerkohet qe të dorëzohen së paku 3 prerje karakteristike, ofertuesi i ponetuar me numrin maksimal të poenave nuk i ka dorëzuar 3 prerje. Duhet të merret parasysh gjatë procesit të vlerësimit.

Eksperti Teknik konsideron se pretendimi 5 i OE ankues eshte i bazuar.

Pretendimi ankimor 6:

2. ËSHTË APLIKUAR FASADA GJYSEM STRUKTURALE (NE FASADËN LINDORE DHE VERIORE), DRITARE PA NDËRPRERJE ME MURI TEK ZYRET E GJYKATËSVE BRENDË SECILIT KAT, E QË SAKT NË DETYRËN PROJEKTUESE ËSHTË KËRKUAR TË MOS PËRDORET, PASI KEMI HASUR NE VESHTIRËSI GJATË EKZEKUTIMIT TË PUNIMEVE NË TË KALUARËN, PËRQIMI I ZËRIT NGA NJËRA ZYRE NË TJETRËN ETJ.

Pergjigje e ekspertit teknik ne Pretendimin 6:

Në detyrën projektuese është dhënë vërejtja që "Fasadat e jashtme te objektit "Gjysëm Strukturale dhe Strukturale" **NUK PRANOHEN**".

Oferta fituese ka përdorur këtë lloj fasade në pjesë të objektit gjë që komisioni profesional- Juria nuk e ka marrë parasysh në vlerësimin e projektit.

Në pikën 11.2 të Përshkrimit teknik Punimi i Fasadës, është specifikuar ky pozicion. Shih foton mëposhtë.

11.2 Punimi i fasadës Gjysem strukturale,

- Punohen sipas skemave grafike F1.F2.F3.F4.F5.F6 dhe F7

Fasada gjysem strukturale si teresi duhet të ketë koeficientin e depertueshmërisë termike, jo më pak të favorshëm se $1.2W/m^2 \cdot K$.

Xhami i përdorur në fasadën gjysem strukturale duhet të jetë si panel dystinore, me dimensione:

Nga ana e jashtme qelq i kalitur $t=6mm$, ndërsa nga ana e mbrendshme të jete qelq "Low E" $t=6mm$.

Në mes të dy paneleve të qelqit të vendoset shtresa e Gazit "Argon", $t=18mm$. Ngjyra e qelqit të jete e kaftë në të hirtë.

Hapja: Sipas skemes

Sistemi mbajtës i fasadës gjysem strukturale të jete e tipit "KASETOR" - "M4". Ngjyra antracid (shiqo skemat grafike)

Realizimi të bëhet sipas instruksioneve nga prodhuesi.



Ky fakt duhet të merret parasysh dhe gjatë vlerësimit dhe të poentohet me numrin më të vogël të pikëve.

Eksperti Teknik konsideron se pretendimi 6 i OE ankues është plotësisht i bazuar.

Pretendimi ankimor 7:

3. MUNGON PARAMASA ME PARALLOGARI E PËRAFËRT, POR VETËM KOSTOJA E PËRAFËRT E NDËRTIMIT PA NDONJË KALKULIM PARAPRAK.

Pergjigje e ekspertit teknik në Pretendimin 7:

Pretendimi ankimor se mungon paramasa dhe parallogaria, sipas detyrës projektuese tek përshkrimi i projektit ideor është kërkuar pika 8. Kosotja e përafërt financiare gjë të cilën nuk e ka plotësuar OE fitues.

Eksperti Teknik konsideron se pretendimi 7 i OE ankues është i bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, kriteret e dhena në dosjen e tenderit për vlerësimin e ofertave dhe rendesise së fakteve të gjetura gjatë shqyrtimit të projektit ideor, të cilat mund të ndikojnë në procesin e vlerësimit të ofertave dhe ndryshimin e renditjes së poentimit, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet si e bazuar**, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Fatktet e gjetura - pretendimet e bazuara, duhet të merren parasysh nga AK dhe të merren për bazë në procesin e vlerësimit sipas kriterëve të vlerësimit dhe poentimit të percaktuara në dosjen e tenderit.

Sqarim Shtesë për Panelin shqyrtues:

Rregullorja për Prokurim Publik 001/2022 jep sqarim në lidhje me përdorimin e konkursit të projektimit:

Përdorimi i konkursit për projektim

55.5 Konkursi për projektim mund të përdoret për çfarëdo projekti në të cilin autoriteti kontraktues mbështetet në kandidatët që ata të furnizojnë zgjidhjet për ndonjë kërkesë të veçantë që mund të paraqitet në një plan, projektim, skicë skematike, model apo forma tjera vizuale

55.6 Konkursi i projektimit është i kufizuar në marrjen e planit ose projektimit për një projekt, qoftë me ose pa tekst mbështetës apo shpjegim, për të cilën autoriteti kontraktues ka vetëm disa kushte bazike.

55.7 Procedura nuk mund të përdoret për furnizimin e shërbimeve (*përveç planit ose vet projektimit*). Aty ku kërkohen punimet apo shërbimet me qëllim që të zbatohet plani apo projektimi, atëherë kontrata për ekzekutimin e shërbimeve apo punimeve duhet të jepet veçmas.

Në këtë rast AK ka përdorur konkurs projektimi duke përfshirë edhe shërbimet e mbikëqyrjes së realizimit të projektit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Këshilli Gjyqësor i Kosovës.
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. - Gjilan

Enver BYTYÇI

